

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
SKY SERVICES SHPK**

---

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortaku**

Shoqëria është themeluar nga ortakët:

1. **z. Ronald Skënderaj**, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, në datën 06.08.1995, mbajtës i pashaportes nr. BR3403824 dhe me numër personal J50806106H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **z. Neldar Malkaj**, shtetas shqiptar, i lindur në Cakran, Fier, në datën 07.09.1986, mbajtës i letërnjoftimit nr. 036225523 dhe me numër personal I60907080R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

**Neni 2  
Emri**

2.1 Emri i shoqërisë është **SKY SERVICES Sh.p.k** (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3  
Selia e Shoqerise**

- 3.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Lagja Bishanak, Rruga Skenderbeu Zyra Nr.1 ( Karburanti Bol Oil ) me numer pasurie 1/417,Zk 8532.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 4  
Forma ligjore**

4.1 Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 5  
Kohëzgjatja**

5.1 Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pakufizuar.

**Neni 6  
Objekti i aktivitetit**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të konsistoj në të gjitha llojet e aktiviteteve sipas klasifikimit kombëtar të aktiviteteve, përveç atyre aktiviteteve për të cilat kërkohet miratimi ose akti i një organi shtetëror ose organi të autorizuar.
- 6.2 Fusha kryesore e aktivitetit do të jetë:

Tregtimi i të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhira të tipeve të ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve të ndryshme të karakterit publik, industrial,



bujqesor, tregtar, kulturor, sportiv, sherbimeve, pjese kembimi, goma te ndryshme, bateri automjetesh. Importimin dhe eksportimin e tyre.

Tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, materiale ndertimi, pajisje elektronike, hidraulike dhe elektrike, vegla pune, Vajra lubrifikante, servis makinash.

~~Tregeti te pajisjeve elektronike, kompjutera, kancelari, aksesore, Tregitim materiale elektrike dhe pajisje laboratorike, transformator, elektromotorr dhe riparim sherbim per transformatore dhe elektromotorra.~~ Tregtimi import eksport me shumice dhe pakice te materialeve dhe pajisjeve elektrike, industriale e elektro-shtepiake, pajisjeve e sistemeve te impianteve te ftohjes ngrohjes, kondicionere si dhe impiante te tjera te ndryshme te cfardolloji.

Projektim dhe instalim i pajisjeve elektrike, industriale, elektroshtepiake sistemeve te ftohjes ngrohjes, kondicionere, sherbime mirmbajtje dhe servisi te ndryshme per materialet e pajisjet elektrike dhe industriale. Punime Lyerje, Suvatime, Gips.

Tregtim I tekstileve dhe veshjeve te punes.

#### **Import-Export, tregtim dhe sherbim i:**

Makinerive te tonazhit te lehte, mesem dhe te rende me goma dhe zinxhire, mjete lundruese, automjeteve, motocikletave.

Pajisjeve dhe impjanteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, kulturor, sportive, tekstile dhe veshje pune.

Pajisjeve elektronike, elektrike, laboratorike elektroshtepiake, sistemeve te impianteve te ftohjes ngrohjes, materialeve elektrike, hidraulike ndertimi, vegla pune.

Pajisjeve elektrike dhe elektronike te prodhimit, transmetimit, shperndarjes, kontrollit dhe matjes se energjise elektrike si: transformatore, gjenerator, elektromotorr, matesa inteligjente, impiante te prodhimit dhe furnizimit me energji, sisteme automatike industrial dhe sisteme te ndricimit.

Pajisje autoservisi, pjese kembimi, goma te llojeve te ndryshme, bateri dhe lubrifikanteve te ndryshem. Riparime dhe mirmbajtje te te gjitha makinerive dhe automjeteve, sherbime mekanike, motorrike, xhenerike, elektroauto, saldimi, kovergjence, sistem i frenimit, llamarinist, bojaxhi, lavazho etj.

#### **Projektim dhe instalim i:**

Pajisjeve elektronike, elektrike, laboratorike, industriale, elektro-shtepiake, sistemeve te ftohjes/ngrohjes. Ndertime, sherbime ,punime dhe riparime te llojeve t ndryshme.

Sherbim karrotreci.

Tregtim i produkteve kimike te perdorshme per trajnimin e ujrave te destinuara per konsumin njerezor, perdorim industrial dhe ekologjik.

Tregtim kaseta te matesave te ujit, panele metalike, panele dhe konstruksione metalike.

Tregtim dhe instalim stacionesh laboratorike per analiza dhe monitorim te ajrit, tokes, ujit etj. Dhenie e automjeteve me qera, Shitblerje automjetesh import export. Dhenie mjjetesh te renda industriale me qera.

## **PJESA II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

#### **Neni 7**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

7.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Një qindmijë) Lekë (*\*sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë\**) i ndare ne 2 ( dy ) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme::

1. **Ronald Skënderaj**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1 ( nje ) kuote, me vlerë nominale 50 000 (pesedhjetë mijë) lek, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Neldar Malkaj**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1 ( nje ) kuote, me vlerë nominale 50 000 (pesedhjetë mijë) lek, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



### III. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

#### Neni 8

##### Përgjegjësia e kufizuar

8.1 Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

#### Neni 9

##### Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

9.2 Cdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

#### Neni 10

##### Të drejtat për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë

10.1 Ortakët do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrjen e shoqërisë në mbledhjen e ortakëve.

10.2 Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë personalisht ose me prokurë, të informohet mbi çështjet e shoqërisë dhe të kontrolloj dhe auditoj librat dhe regjistrat e shoqërisë.

#### Neni 11

##### Detyrimet e ortakëve

11.1 Ortakët janë të detyruar të paguajnë kuotën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë, nëse thirren rregullisht, të ndihmojnë shoqërinë në ushtrimin e aktivitetit dhe në zbatimin e vendimeve të mbledhjes së asamblesë dhe organeve të tjera të shoqërisë, që janë miratuar brenda kompetencave të autoritetit përkatës.

### PJESA IV

### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

#### Neni 12

##### Të drejtat e asamblesë së përgjithshme

12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.

12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.

12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
- (b) pranimin e ortakëve të rinj;
- (c) largimin/përrjashtimin e një ortaku, në përputhje me dispozitat statutorë në fuqi;
- (d) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
- (e) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
- (f) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (g) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
- (h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;



- (i) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (k) të vendosë për investimet;
- (l) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (n) të delegoj apo revokojë një prokure apo autorizim për të vepruar në emër të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- (t) të ngre padi kundër anëtarëve të organeve të shoqërisë ose kundër ortakëve të tjerë;
- (u) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (v) të marrë hua;
- (w) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (x) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

### Neni 13

#### Vendimet e asamblesë së përgjithshme

- 13.1 Vendimet e renditura përse i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës. Vendimet për çështjet e tjera të renditura në nenin 12.3 të Statutit, merren me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 13.2 Në mbledhjen e Asamblesë votimi do të kryhet i hapur. Në raste të vecanta, në varësi të çështjeve specifike, vendimi mund të merret më votim të fshehtë, në përputhje me dispozitat statutore.

### Neni 14

#### Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratori të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilet përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorit mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.



- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së përgjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

#### **Neni 15**

##### **Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme**

- 15.1 Vendimet në asamblenë e përgjithshme, të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, do të kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
- 15.3 Prokura duhet të jetë e noterizuar dhe të paraqitet në mbledhjen e asamblese. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.4 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.5 Nëse mbledhja e asamblese se përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

##### **Drejtimi i mbledhjes se asamblese se përgjithshme**

- 16.1 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

#### **Neni 17**

##### **Procesverbali i mbledhjes së asamblese se përgjithshme**

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka



publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

## **PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18**

#### **Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale për administratorin.
- 18.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që t'a përfaqësojnë atë në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - c) marrja e huave në emër të shoqërisë dhe vendosja mbi kushtet e huasë;
  - d) përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
  - e) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
  - f) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
  - h) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënies të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
  - i) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
  - j) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
  - k) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
  - l) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
  - m) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;



- n) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- o) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e ~~përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;~~
- p) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- q) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi e mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:

1. **z. Ronald Skënderaj**, shtetas shqiptar, i lindur në Fier në datën 06.08.1995 dhe banues në adresën Lagja Kryengritja e Fierit, Pallati perballë UMB, , mbajtës i pashaportes nr. BR3403824 dhe me numër personal J50806106H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

## PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

### Neni 19

#### Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.
- 19.2 Në fund të cdo viti financiar, administratorët do të përbushin detyrat e mëposhtme:
  - (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

### Neni 20

#### Fitimi i Shoqërisë

- 20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri, si më poshtë:
  - a) 50% e fitimit do të shpërndahet tek **z. Ronald Skënderaj**, si zotëruesi i një kuote, që përfaqëson 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të shoqërisë.
  - b) 50% e fitimit do të shpërndahet tek **z. Neldar Malkaj**, si zotëruesi i një kuote, që përfaqëson 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të shoqërisë.
- 20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do



të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

## **PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 21 Prishja dhe likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## **PJESA VIII TE PERGJITHSHME**


### **Neni 22 Te pergjithshme**


- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

## **ORTAKET**

**Z. Ronald Skënderaj**

**Z. Neldar Malkaj**

Ronald Skënderaj  


Neldar Malkaj  


DT. 03.08.2020